

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5859
E premte, 23 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Taksa rrit importin
e mallrave përmes
transportit hekurudhor

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFUNDON LEGJISLATURA E GJASHTË E KUVENDIT TË KOSOVËS | FAQE 4 - 5

Vetëshpërndahet Kuvendi, hapet rruga për zgjedhje

Ashtu siç pritej, deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë votuar të enjten për shpërndarjen e legjislaturës së VI të Kuvendit të Kosovës. Me 89 vota për, një kundër dhe dy abstenime, deputetët u kanë hapur rrugë zgjedhjeve të parakohshme që pritet të mbahen në fund të muajit shtator apo në fillim të muajit tetorit. Opozita ka drejtuar kritika të shumta ndaj shumicës parlamentare të kësaj legjislature, kurse edhe kjo e fundit ka pranuar se kjo legjislaturë ka pasur deputetë dembelë. Pas shpërndarjes së Kuvendit, secili lider partiak është shprehur i bindur se qeveria e ardhshme do të udhëhiqet nga partitë e tyre



AKTUALE

**SBASHK-U ME VEPRIME
KONKRETE KUNDËR MBYLLJES
SË SHKOLLAVE NË KAMENICË** F. 7

**KOMUNA E DRENASIT, APEL
QYTETARËVE: TË KENI KUJDES
NDAJ ZJARRVËNIEVE** F. 10

**POLICIA KONFISKON
31 KILOGRAMË SUBSTANCË
NARKOTIKE E LLOJIT
MARIJUANË** F. 6

EKONOMI

**KUVENDI MIRATON
MARRËVESHJEN FINANCIARE
IPA 2018** F. 9

**PAS 31 GUSHTIT TELEKOMI NUK
DO TË OFROJË MË SHËRBIME
PËR 'Z-MOBILE'** F. 8



KULTURË

**NËNSHKRUHEN DY RREGULLORE
TË CILAT PËRMIRËSOJNË
FUSHËVEPRIMTARINË E
TEATROVE DHE ANSAMBLIT
REZIDENTE** F. 6

SPORT

**KAMPIONI I GJERMANISË
NË NOT DO TË GAROJË
PËR KOSOVËN** F. 17

**DRENICA DHE LLAPI NUK
MENDOJNË PËR HUMBJE** F. 16

Pompeo vendosi parimin që i mungonte dialogut të Brukselit, reciprocitetin



Kërkesa e sekretarit amerikan të shtetit, Mike Pompeo, se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me një reciprocitet, është mirëpritur nga njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ish-diplomati dhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë se sekretari Pompeo ka vendosur parimin që i ka munguar shtatë vjet dialogut të Brukselit, reciprocitetin | FAQE 3

**Hoxhaj:
Gjatë kësaj
legjislature
e qeverisjeje
ka rënë
dukshëm
besimi i
qytetarit në
institucione** | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Mbërrin në Presidencë dorëheqja e Valdrin Pjetrit

TRANË, 22 GUSHT - Prefekti i Qarkut të Shkodrës, Çesk Millja, i ka dërguar presidentit Ilir Meta dokumentin e dorëheqjes së Valdrin Pjetrit, si dhe e ka njoftuar për ngërçin e krijuar në Bashkinë e Shkodrës.

Në dokumentin e siguruar nga mediet, thuhet se është konsti-

tuuar Këshilli Bashkiak, i cili përbëhet nga 51 anëtarë, ndërsa është vakant vendi i kryetarit të bashkisë.

Kësisoj, topi hidhet zyrtarisht në fushën e Metës për nxjerrjen e një dekreti të ri për zgjedhjet në Shkodër.

Pak ditë më parë kreu i shtetit deklaroi se nuk do të dekretojë

datë të re zgjedhesh në Shkodër, pasi nuk e njeh 30 qershorin. 13 tetori është dita kur votohet në gjithë vendin tha kreu i shtetit, datë që nuk njihet nga mazhoranca që ka kapur të gjithë bashkitë e vendit, por as nga PD-ja, pasi ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në ato zgjedhje.



Presidenti Trump këmbëngul se demokratët janë të dëmshëm për Izraelin

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha se hebrejtë amerikanë që votojnë për demokratët tregojnë ose një mungesë totale dijeje, ose një mungesë të madhe besnikërie dhe demokratët duan të bëjnë shumë gjëra që dëmtojnë Izraelin

WASHINGTON, 22 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump vazhdoi të këmbëngulte të mërkurën që hebrejtë amerikanë duhet të votojnë për republikanët, sepse votimi për një demokrat do ta tregonte injorancën nga ana e tyre ose mungesë besnikërie. Deklarata e tij fillestare para disa ditësh ishte pjesë e një sulmi ndaj katër ligjvënësve demokratë, dy prej të cilave janë ndaluar ta vizitojnë Izraelin, me sa duket me nxitjen e tij. Shumë hebrej amerikanë thonë se vënia në diskutim e besnikërisë së tyre nga Trumpi është e ngjashme me një paragjykim historik që ka ushqyer ksenofobinë kundër hebrejve në të gjithë botën. Komentet e presidentit Trump kanë shkaktuar reagime të ndryshme në Izrael, ka njoftuar

voa.

Trump i ritheksoi komentet e së martës se hebrejtë amerikanë që votojnë për demokratët "tregojnë ose një mungesë totale dijeje ose një mungesë të madhe besnikërie". Para se të nisej për një vizitë në Kentucky, presidenti shkoi edhe më tej, duke thënë se demokratët duan të bëjnë shumë gjëra që dëmtojnë Izraelin. "Sipas mendimit tim, nëse votoni për demokratët, po tregoheni shumë jo besnikë ndaj popullit hebre dhe Izraelit. Dhe vetëm njerëzit e dobët nuk do ta thoshin këtë", tha ai.

Udhëheqësi i pakicës demokrate në Senat, Chuck Schumer, ligjvënës hebre me peshë në Kongresin amerikan, dënoi komentin në "Twitter", duke thënë se nxit- me dashje



ose pa dashje - antisemitët në të gjithë vendin dhe botën.

Senatori Bernie Sanders nga Vermonti, i vetmi hebre që kandidon për president, reagoi ndaj komentit në një tubim në Iowa të martën. "Unë jam një hebre krenar dhe nuk kam asnjë problem të votoj për demokratët. Dhe në fakt, unë kam ndërmend të votoj për një hebre që të bëhet presidenti i ardhshëm i Shteteve të Bashkuara", tha ai.

Shumë hebrej në Izrael mbështetën presidentin amerikan. "Ai ka të drejtë - 1 milion për qind. Ata nuk janë besnikë. Demokratët nuk janë besnikë. Ata ishin gjithmonë kundër nesh, kundër njerëzve, kundër vendit, kundër Izraelit. Ata na sollën Klintonin dhe Obamën. Çfarë bëri Obama? Vetëm solli probleme. Trumpi ka të drejtë", thonë ata.

Të tjerë, përfshirë studiuesin dhe analistin nga Tel-Avivi,

Shmuel Rosner, shprehën shqetësimin. "Ne e dimë nga historia jonë e gjatë se dyshimet për besnikërinë e hebrejve nuk i shërbejnë kurrë popullit hebre. Qoftë nëse bëhet fjalë për besnikërinë ndaj vendeve të tyre, apo besnikërinë ndaj popullit të tyre, këto gjithmonë shërbejnë si municion në duart e armiqve të hebrejve. Dhe kur presidenti i Shteteve të Bashkuara thotë diçka të tillë, kjo krijon një mjedis ose atmosferë, që është e pashëndetshme dhe e pasigurt për shumicën e hebrejve", tha Rosner.

Sondazhet e fundit tregojnë se rreth 75 % e hebrejve amerikanë identifikohen si demokratë. Komentet e presidentit Trump për "besnikërinë" shihen si një përpjekje për ta ndryshuar këtë shifër. Pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, shumë hebrej janë të shqetësuar se sugjerimet se ata janë më besnikë ndaj Izraelit dhe besimit të tyre sesa ndaj vendit të tyre mund të rrezikojnë sigurinë e tyre në një klimë rizgjimi të supremacistëve të bardhë dhe neo-nazistëve.

PD-ja kërkon verifikimin e kryebashkiakut të Vorës

TRANË, 22 GUSHT - Partia Demokratike, iu drejtua zyrtarisht Prokurorisë duke kërkuar që të nisë verifikimet lidhur me kryebashkiakun socialist të Vorës, Agim Kajmaku. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm demokrat Gazmend Bardhi, ka dyshime të arsyeshme se Kajmaku mund të jetë subjekt i të ashtuquajturit ligj për dekriminalizimin, pasi mund të ketë qenë i dënuar dhe më pas i dëbuar nga Greqia. Kryebashkiaku Kajmaku hodhi poshtë akuzat duke deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë i dënuar

apo dëbuar nga asnjë shtet i Bashkimit Evropian.

Pasi prej kohësh e kishte përmendur emrin e tij mes kryebashkiakëve të rinj socialist me një të kaluar, sipas saj, kriminale, PD-ja iu drejtua të enjten zyrtarisht Prokurorisë së Përgjithshme për nisjen e verifikimeve ndaj kryebashkiakut të Vorës, Agim Kajmaku. Në një letër të firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm Gazmend Bardhi, theksohet se kërkesa vjen në kushtet kur ekzistojnë të dhëna, të bëra publike më parë, se Kajmaku është subjekt i Ligjit të Dekriminalizimit

dhe nuk mund të ushtrojë funksion publik, pasi sipas PD-së "ai dyshohet se ka qenë i arrestuar /ndaluar në Greqi dhe, më pas, ndaj tij është marrë masa e dënimit dhe dëbimit nga autoritetet përgjegjëse greke", thuhet në kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të PD-së. Një fakt që nuk rezulton në formularin e plotësuar nga kryebashkiaku i Vorës, i cili megjithatë ka pranuar më herët se ka ndryshuar emrin në Jorgo Toto, duke shpjeguar se këtë e ka bërë në mesin e viteve '90 për të përfutur vizë udhëtimi në shtetin grek.



Pompeo vendosi parimin që i mungonte dialogut të Brukselit, reciprocitetin

Kërkesa e sekretarit amerikan të shtetit, Mike Pompeo, se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me njohje reciproke, është mirëpritur nga njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ish-diplomati dhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë se sekretari Pompeo ka vendosur parimin që i ka munguar shtatë vjet dialogut të Brukselit, reciprocitetin

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 GUSHT - Profesi i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë të enjten se për vetëm një muaj artileria e rëndë diplomatike ka vendosur parimin që i ka munguar shtatë vjet dialogut të Brukselit, reciprocitetin. Ai ka thënë se përderisa Macroni kërkoj ndryshimin e preambulës së Kushtetutës serbe dhe vazhdimin e dialogut si dy shtete, Quinti kërkoj lëshime reciproke nga dy shtetet, kurse Pompeo kërkoj një marrëveshje finale me njohje reciproke midis dy shteteve. "Për vetëm një muaj artileria e rëndë diplomatike vendosi parimin që i mungonte shtatë vjet dialogut të Brukselit, reciprocitetin. Macroni kërkoj ndryshimin e preambulës së Kushtetutës serbe dhe vazhdimin e dialogut si dy shtete, Quinti kërkoj lëshime reciproke po nga dy shtetet, kurse Pompeo, një marrëveshje finale me njohje reciproke midis dy shteteve. Ku mbet Mogherini?", ka shkruar Reka në llogarinë e vet në "Facebook".

Një ditë më parë sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ka takuar në Nju Jork presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ku temë kryesore ka qenë Kosova. Sipas komunikatës së lëshuar nga Departamenti i Shtetit, sekretari Pompeo ka porositur që të dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përfundojë me njohjen reciproke.

Pompeo ka thënë se të dyja palët duhet t'i shmangin provokimet



që mund ta dëmtojnë procesin e normalizimit si dhe të tregojnë shpirt fleksibiliteti për të siguruar një marrëveshje që do ta mënjanonte ngecjen e të dyja vendeve. "Sekretari Michael R. Pompeo takoi sot në Nju Jork presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Sekretari Pompeo foli për raportet e ngushta mes ShBA-së dhe Serbisë. Sekretari dhe presidenti Vuçiq diskutuan për vizionin bilateral në stabilitetin, sigurinë dhe perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vazhdimin e mbështetjes së

ShBA-së për integrimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. Sekretari Pompeo inkurajoi Serbinë që të fokusohet në këtë pikë duke realizuar reformat e nevojshme si dhe të rinisë dialogu me Kosovën për normalizimin e raporteve mes të dyja vendeve e që do të përfundonte me njohjen reciproke. Sekretari ka potencuar se të dyja palët duhet t'i shmangin provokimet që mund ta dëmtojnë procesin e normalizimit si dhe të tregojnë shpirt fleksibiliteti për të siguruar një marrëveshje që do ta mënjanonte ngecjen e të dy

vendeve", është thënë në deklaratën e Departamentit të Shtetit pas takimit të sekretarit amerikan Mike Pompeo dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Kurse presidenti serb Aleksandër Vuçiq i ka thënë sekretarit Pompeo se Serbia është e gatshme t'i kthehet dialogut në momentin që Prishtina heq takсэн e vendosur ndaj produkteve serbe. Për vazhdimin e procesit të dialogut ka folur për gazetën "Epoka e re" edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi. Ai ka thënë se pas

zgjedhjeve në Kosovë do të riaktualizohet agenda e dialogut. Sipas Gashit, thirrja e fundit e Quintit tregon se ky proces duhet të dinamizohet menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet. "Agjenda e dialogut do të riaktualizohet menjëherë pas zgjedhjeve. Për këtë ka insistim dhe angazhim të partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtarë si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), po ashtu edhe nga vendet më të fuqishme të Bashkimit Evropian (BE). Thirrja e fundit e Quintit tregon se ky proces duhet të dinamizohet menjëherë pas konstituimit të institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet. Kjo mendoj se do të ndodhë pavarësisht kush do ta udhëheqë qeverinë e ardhshme, madje edhe nëse në krye të ekzekutivit do të jenë partitë që për një kohë të gjatë janë deklaruar kundër dialogut dhe kanë përdorur mjete të paligjshme për ta penguar atë", është shprehur Gashi.

Ndërsa ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka se pengesat kryesore për vazhdimin e dialogut janë në Beograd. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ndërkombëtarët duhet t'i bëjnë presion Serbisë. "Presioni i vendeve perëndimore duhet të drejtohet mbi Beogradin, pasi aty janë pengesat kryesore për dialogun dhe rezultatet pozitive të dialogut të zhvilluar për disa vjet në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së. Pas vendimit të GJND-së, se pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare, presioni ndërkombëtar është dashur ta ketë vetëm një adresë: Serbinë!", ka deklaruar Krasniqi për gazetën "Epoka e re".

Hoxhaj: Gjatë kësaj legjislature e qeverisjeje ka rënë dukshëm besimi i qytetarit në institucione

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, duke folur për shpërndarjen e legjislaturës së VI të Kuvendit të Kosovës, ka thënë se ky vendim përbën një kthesë në politikën e vendit tonë. "Vendi ynë ndodhet para vendimeve të mëdha dhe ka shumë rëndësi se cila përbërje do ta fitojë besimin e qytetarëve për t'i prirë në etapën e re: atë të hapjes së perspektivave të reja për Kosovën e qytetarët e

saj, përfundimin e bisedimeve dhe afrimin e Kosovës drejt BE-së dhe mekanizmave ndërkombëtarë", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka theksuar se në këtë fazë është e rëndësishme të mos dehemi nga ndjenja e madhështisë për veten, por të jemi mirënjohës e falënderues për të gjithë miqtë ndërkombëtarë, për shtetet mike të cilat e ndihmuan zhvillimin e Kosovës deri sot. "Shtetet nuk janë entitete të ndara që funksionojnë si ishuj të veçuar.

Shtetet bashkekzistojnë dhe bashkëpunojnë sepse edhe vendimet e marra në nivel lokal ndikojnë në përparimin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore globalisht. Dhe ne duhet të veprojme si njerëz të vetëdijshëm për qenien tonë si pjesë e botës së qytetëruar. Jemi të vetëdijshëm se gjatë dy vjetëve të kësaj legjislature e qeverisjeje ka rënë dukshëm besimi i qytetarit në institucione", ka deklaruar Hoxhaj.



Përfundon legjislatura e gjashtë e Kuvendit të Kosovës

Vetëshpërndahet Kuvendi,



Ashtu siç pritej, deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë votuar të enjten për shpërndarjen e legjislaturës së VI të Kuvendit të Kosovës. Me 89 vota për, një kundër dhe dy abstenime, deputetët u kanë hapur rrugë zgjedhjeve të parakohshme që pritet të mbahen në fund të muajit shtator apo në fillim të muajit tetorit. Opozita ka drejtuar kritika të shumta ndaj shumicës parlamentare të kësaj legjislature, kurse edhe këta të fundit kanë pranuar se kjo legjislaturë ka pasur deputetë dembelë. Pas shpërndarjes së Kuvendit, secili lider partiak është shprehur i bindur se qeveria e ardhshme do të udhëhiqet nga partitë e tyre

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 GUSHT - Me 89 vota për, një kundër dhe dy abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për shpërndarjen e legjislaturës së VI, duke iu hapur rrugë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Seanca e fundit e kësaj legjislature ka qenë e qetë, ku deputetët e pozitës dhe të opozitës janë parë mjaft të qetësuar, duke bërë edhe fotografi së bashku në këtë mandat. Fillimisht deputetët e të dy taborëve, me 103 vota kanë miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, marrëveshje kjo që ia sjell Kosovës 90 milionë euro. Më pas në rend të ditës ka qenë

pika kryesore, për çka edhe ishte thirrur kjo seancë. Mocioni i deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit, të cilin e ka lexuar shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi.

Kryeparlamentari Kadri Veseli ia ka dhënë fjalën shefit të grupit parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, i cili ka thënë se me shpërndarjen e kësaj legjislature po largohet edhe qeveria PAN. "Qeveria e PAN-it (koalicioni PDK, AAK dhe Nisma) do të mbetet në histori si qeveria më e madhe në botë me 454 të emëruar politikë, kryeministri me 35 këshilltarë, me pesë zëvendëskryeministra e me 80 zëvendësministra", ka thënë Hoti.

Pas fjalimit të Hotit, kryeparlamentari Veseli ka kërkuar mendimet e shefave të grupeve

parlamentare nëse ka nevojë të ketë debat apo vetëm nga një deklaratë të grupeve parlamentare para se të shkohet në votimin e mocionit të shpërndarjes së kësaj legjislature. Disponimi ishte që të shkohet drejtpërdrejt në votimin e mocionit, çka rezultoi me vendimin për shpërndarjen e Kuvendit. Pas shpërndarjes së Kuvendit, liderët politikë janë shprehur të kënaqur me veprimin e deputetëve, duke thënë se tani është koha që të flasë sovranin në zgjedhjet që pritet të shpallen së shpejti nga presidenti Hashim Thaçi.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka deklaruar se për të ardhur deri te momenti i shpërndarjes së Kuvendit me kohë janë ndërmarrë të gjitha iniciativat ligjore. "Unë jam Kadri Veseli.

Do të jem kandidat për kryeministër të Republikës së Kosovës. Veç diçka në jetë di, me e mbajt fjalën gjithmonë. Kur kam thënë se do të ketë zgjedhje, do të ketë zgjedhje, kur kam thënë se do të largohen të gjithë uzurpatorët nga pronat e uzurpuara, se ligji është më i fortë se secili i fortë që mendon në Kosovë, janë larguar. Kështu do të jetë edhe lufta kundër korrupsionit", ka thënë Veseli, duke shtuar se Kosova asnjëherë nuk do të dështojë. "Këto zgjedhje janë për t'u dhënë një legjitimitet më të fuqishëm qytetarëve, të rinjve, grave në luftën kundër korrupsionit dhe perspektivën e modernizimit të shtetit, një shtet drejtë, një shtet ligjor, një shtet perëndimor, me ShBA-në. Ky është drejtimi ynë. Të gjitha drejtimet mund të fliten, mund të na kthejnë mbrapa, por njerëzit e Kosovës nuk mund të dështojnë dhe Kosova nuk do të dështojë. Kemi për të ecur përpara", është shprehur Veseli. Ndërsa kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, veprimin e deputetëve e ka vlerësuar si pjekuri politike, duke thënë se tani është koha që të flasë sovranin. "Forcat politike tani i kanë mundësitë që t'i ofrojnë një koncept zhvillimor vendit. Me konceptin 100 për

qind shtet kemi bashkëpunuar tashmë me PSD-në, por jemi të hapur edhe për Nismën e AKR-në. Sot jemi fitues si Kosovë me këtë pjekuri që kemi treguar dhe kemi dërguar një sinjal për demokracinë që kemi. Me rëndësi është që qytetarët të fokusohen në konceptet që kanë partitë", ka deklaruar Haradinaj.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, pas shpërndarjes së Kuvendit ka thënë se deputetët kanë shfrytëzuar mundësinë që t'ua kthejnë qytetarëve mundësinë e zgjedhjes. Ai ka theksuar se qeveria e ardhshme të cilën pretendon se do ta udhëheqë Vetëvendosje nuk do të merret me vendime të mëdha, por me punë të mëdha. "Nuk do të merren vendime të mëdha si rasti i demarkacionit të Murat Mehës në këmbim të liberalizimit të vizave që nuk erdhi, por me punë të mëdha, do të ketë prokurorë të guximshëm, arsim cilësor dhe shëndetësi. Kemi shumë punë të mëdha, por kurrë vendime të mëdha", ka thënë Kurti.

Shpërndarjen e Kuvendit e ka komentuar edhe lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, i cili ka thënë se ky subjekt politik do të garojë në këto zgjedhje me një program që do t'i adresojë sfi-

hapet rruga për zgjedhje



Ambasada e ShBA-së: Kuvendi mori vendim të rëndësishëm drejt krijimit të qeverisë së re

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë ka konsideruar se vendimi i Kuvendit të Kosovës për ta shpërndarë legjislaturën e gjashtë përbën hap të rëndësishëm drejt krijimit të qeverisë së re. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", kjo ambasadë ka thënë se "Kuvendi ka

ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një qeverie të re. Një fushatë në të cilën kandidatët ofrojnë ide të reja mbi bisedimet me Serbinë, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, do të siguronin që Kosova të mos humbasë edhe më shumë kohë në ndërtimin e një themeli për të ardhmen".

Propozimi i deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit ka pasuar dorëheqjen e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës më 19 korrik, pasi që të njëjtën ditë kishte marrë ftesë nga Gjykata Speciale e Kosovës me seli në Hagë, për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte.

Legjislatura e VI apo Kuvendi i dembelëve

Në ditën që deputetët vendosën për shpërndarjen e Kuvendit nuk kanë munguar edhe komentet negative për këtë legjislaturë nga vetë ata që ishin pjesë e saj. Seanca për shpërndarjen e Kuvendit ka filluar me vlerësimin e Kadri Veselit se kjo përbërje e legisla-

tivit kishte në vete shumë deputetë dembelë.

Më pas për këtë çështje ka shkruar edhe ish-deputeti i AAK-së, Muharrem Nitaj. Në profilin e vet në "Facebook", Nitaj ka shkruar se me këtë përbërje mos e paftë Kuvendin herën tjetër, duke shtuar se në këtë legjislaturë kishte shumë fjalë e pak ide. "Përfundoi një legjislaturë e Kuvendit, që me këtë përbërje, mos e pafsha herën tjetër! Një legjislaturë ku kishte shumë fjalë e pak ide. Një legjislaturë ku kishte çdo gjë, por jo kulturë debati. Shumë prej deputetëve e kishin veç një detyrë: për ta shpërfytyruar Kuvendin. Kjo është pjesa që mos na raftë ta harrojmë", ka shkruar Nitaj.

Ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Abin Kurti, nuk e la pa shkruar për të metat e

Thaçi: Së shpejti do të marr vendim për dekretimin e zgjedhjeve të parakohshme

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se shpërndarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës përshpejton hapat e organizmit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, pas dorëheqjes së kryeministrit të Kosovës dhe në mungesë të gatishmërisë së partive politike parlamentare për të krijuar një qeveri të re. Ai ka bërë me dije se brenda kompetencave kushtetuese, ligjore dhe në përpunje të plotë me vendimin e Kuvendit, së shpejti do të marrë vendim për dekretimin e zgjedhjeve të

parakohshme parlamentare në Republikën e Kosovës. "Brenda kompetencave të mia kushtetuese, ligjore dhe në përpunje të plotë me vendimin e sotëm të Kuvendit, së shpejti do të marr vendim për dekretimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Republikën e Kosovës. Këto zgjedhje duhet të jenë mirë të organizuara, profesionale, për të siguruar një proces fer, demokratik, që mundëson një monitorim të plotë të organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendore", ka deklaruar Thaçi.

kësaj mazhorance. "Kjo ish-qeveri u pat sajuar mezi, plot tre muaj pas zgjedhjeve të 11 qershorit 2017, me shumicë minimale prej vetëm 61 deputetëve. Dhe, u mbajt në këmbë mezi, si qeveri e pakicës, larg edhe shumicës minimale të domosdoshme. Në njërin anë kjo ishte qeveria më e madhe e pasluftës, me 5 zëvendës kryeministra, 21 ministra e 80 zëvendësministra kurse, në anën tjetër, kryeministri kishte dyfish më shumë parti në koalicionin qeverisës sesa deputetë të partisë së tij në

Kuvend", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook". Kurse ish-deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, ka thënë se i është dhënë fund qeverisë e cila, sipas saj, kishte skandalet më të mëdha në historinë e pasluftës. "Sot i dhamë fund qeverisë me mandatin më të shkurtër, por me skandalet më të mëdha në historinë e pasluftës. Sot është fillimi i fundit të mentalitetit plaçkitës. Nga tetori, po vjen koha e mirëqeverisjes", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".



dat ekonomike dhe partneritetin me perëndimin. "Sot deputetët e Kuvendit të Kosovës votuan në favor të shpërndarjes së Kuvendit dhe hapjes së rrugës së thirrjes së zgjedhjeve që do t'i japin legjitimitet skenës politike. Sfidat me të cilat përballet Kosova janë të mëdha dhe ne kemi nevojë që qytetarët tanë të japin mbështetje për vizionin tonë. Unë dhe AKR-ja do të kandidojmë me një program që do t'i adresojë sfidat ekonomike, partneritetin tonë me Perëndimin dhe angazhimin tonë për sundimin e ligjit", ka shkruar Pacolli në profilin e vet në "Facebook". Kurse ish-shëfi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se deri te ky çast vendi ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të shumë faktorëve qeverisës, por edhe çështjeve të tjera. "Opozita nuk mund të krekoset se e dërgoi qeverinë në shtëpi. Qeveria shpesh, edhe për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme, ka ardhur në një pikë ku ka qenë i pamundur vazhdimi i bashkëpunimit. Pastaj, momentet që janë shfrytëzuar për t'i dhënë fund, janë çështje të tjera. Pra, le të shkojmë sërisht te sovranit", ka thënë Sherifi.

Nënshkruhen dy rregullore të cilat përmirësojnë fushëveprimtarinë e teatrove dhe ansamblet rezidente

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar dy akte nënligjore të cilat rregullojnë fushën e teatrove dhe ansambleve rezidente.

Konkretisht, ministri ka nënshkruar rregulloren për skenën e vogël të Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe rregulloren për themelimin dhe funksionimin e Ansambllit Rezident të aktorëve të Teatrit Kombëtar dhe teatrove të qyteteve.

Me rregulloren për skenën e vogël të TKK-së, përcaktohet funksionimi, përmbajtja programore, angazhimet, kategoritë, kushtet, kriteret, procedurat dhe përgjegjësitë e veprimit në skenën e vogël të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Rregullorja parasheh që scena e vogël do t'i shërbejë TKK-së si një laborator për kultivimin e shprehjeve inovative dhe eksperimentale teatrore. Ajo do të mbështetë dhe nxitë idetë e reja, format kërkimore, teatrin multimedial, shfaqjet interaktive dhe përmbajtje të ngjashme të gjuhës teatrore, si një strehë e të gjithë atyre që teatrin e shohin ndryshe. Sipas rregullores, repertorin për skenën e vogël të TKK-së e propozon udhëheqësi artistik, duke u bazuar në specifikat estetike të skenës së vogël, i cili hartohet kryesisht nga tekstet avangarde të dramaturgjisë botërore dhe

asaj kombëtare, e që aprovet nga drejtori i përgjithshëm i TKK-së duke iu paraqitur Këshillit Drejtues të TKK-së për miratim.

Rregullorja përcakton që përzgjedhja e regjisorëve për projektet e SV-TKK-së bëhet me konkurs publik. Çdo vit kalendarik, pas aprovimit të repertorit të skenës së vogël, TKK shpall konkurs për regjisor. Regjisorit konkurron me projekt skenik, vizion dhe ide për njërin nga projektet e skenës së vogël. I njëjti regjisor nuk ka të drejtë të konkurrojë për dy projekte në të njëjtin vit.

Projektet e përzgjedhura nën emrin e regjisorit të caktuar i takojnë atij që ta përzgjedhë ekipin kreativ të projektit, të aktorëve nga radhët e aktorëve të jashtëm, ku sipas rregullores, regjisorit i rezervohet e drejta që të organizojë audicion për aktorët, apo ta sjellë listën e gatshme të ekipit të përzgjedhur, ndërkaq aktorët e trupës rezidente të TKK-së, si dhe stafi tekniko-kreativ, të cilët përzgjidhen për të qenë pjesë e projekteve në skenën e vogël, nuk kanë të drejtë ta refuzojnë punën e caktuar.

Rregullorja në fjalë përcakton edhe aspektin buxhetor të skenës së vogël, e cila duhet të ketë buxhet të ndarë nga projekti vjetor financiar i TKK-së e që nuk mund të jetë më i madh se 30 për qind nga buxheti i skenës së madhe.

Ndërsa rregullorja për theme-



limin dhe funksionimin e Ansambllit Rezident të aktorëve të Teatrit Kombëtar dhe teatrove të qyteteve përcakton mënyrën, kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e aktorëve të Ansambllit Rezident të Aktorëve, kategorizimin dhe kohëzgjatjen e angazhimit të tyre në Ansambllin e Teatrit Kombëtar dhe teatrove të qyteteve.

Sipas rregullores së nënshkruar nga ministri Gashi, Teatri Kombëtar ka Ansambllin Rezident të Aktorëve të përbërë prej së paku 30 (tridhjetë) aktorëve të të gjitha moshave, ndërsa teatrot e qyteteve kanë Ansambllin Rezident të Aktorëve të përbërë prej 10

(dhjetë) deri në 20 (njëzetë) aktorësh.

Rregullorja parasheh edhe ndarjen e aktorëve nëpër kategori sikurse janë doajenët (më shumë se 20 vjet përvojë pune, me së paku 30 role kryesore), aktorët e kategorisë së parë (së paku 15 role kryesore), aktorët e kategorisë së dytë (së paku 10 role kryesore) dhe trupa rezidente. Vlerësimi për kategorizimin e aktorëve sipas rregullores bëhet çdo dy vjet nga komisioni i emëruar nga Këshilli Drejtues, ku parashihet edhe zbritja e aktorëve nga kategoria përkatëse, përjashtuar doajenët që nuk u nënshtrohen kriterëve të zbritjes.

Me rastin e nënshkrimit, ministri Gashi ka vlerësuar se MKRS-ja përmbush dhe plotëson infrastrukturën ligjore e cila rregullon dhe përmirëson teatrot dhe ansamblet rezidente të tyre. "Ka qenë përkushtim dhe fokus i yni që nga dita që kemi marrë drejtimin e ministrisë, që të kemi një kujdes të veçantë për fushën e teatrove në Republikën e Kosovës si dhe për aktorët të cilët me punën e tyre përçojnë emocione te publiku duke bartur vlera artistike", ka thënë ministri Gashi, duke shprehur mirënjohjen për drejtuesit dhe bartësit e teatrove si dhe për aktorët për punën që realizojnë.

Policia konfiskon 31 kilogramë substancë narkotike të llojit marijuanë

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka pranuar informacione për një veturë e cila bënte lëvizje të dyshuara. Pas pranimit të këtyre informacioneve, njësisia e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve - Gjakovë, ka dalë në lokacion, me ç'rast ka vëzhguar dy persona të dyshuar, i dyshuari i parë e kishte të parkuar veturën në një parking, në ndërkohë që me veturën e të dyshuarit të dytë kanë vazhduar në drejtim të qytetit të Gjakovës. Drejtoritë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve - Gjakovë dhe Pejë, kanë bërë kontrollimin e veturës së të dyshuarit të parë e cila ka qenë e parkuar, me ç'rast në bagazhin e veturës së njëjtë janë gjetur katër qese të mbushura me substancë narkotike të llojit marijuanë, po

ashtu në cilësi të provave materiale janë konfiskuar edhe disa dëshmi: Katër qese najloni ngjyrë të zeze, në brendësi të tyre të ndara në folje najloni, të mbushura me substancë të dyshuar narkotike e llojit marijuanë, me peshë totale rreth 31 kilogramë e 102 gramë; dy vetura, tre telefona, para të gatshme 75 euro dhe 1 800 lekë të Shqipërisë. Lidhur me rastin është njoftuar prokurori kujdestar, i cili ka udhëzuar të iniciohet rast për "blerje, posedim, shitje ose shpërndarje të paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", po ashtu me urdhër të të njëjtit, të dyshuarve me shtetësi të Shqipërisë u është shqiptuar masa e ndalimit policor për 48 orë.



Taksa rrit importin e mallrave përmes transportit hekurudhor

PRISHTINË, 22 GUSHT - Bizneset në Kosovë po e shfrytëzojnë gjithnjë e më tepër infrastrukturën hekurudhore për transportin e mallrave nga vendet e Bashkimit Evropian. Për gjashtë muajt e parë të këtij viti, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 153 mijë tonë mallra të ndryshme janë transportuar me tren, që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, paraqet një rritje prej 59 përqindësh. Sipas përfaqësuesve të komunitetit të biznesit dhe afaristëve në Kosovë, një nga arsyet e rritjes së transportit me tren ndërlidhet me shpenzimet më të favorshme financiare. Por, arsyeja kryesore potencohet të jetë taksa 100 përqind e vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovinë, e cila i ka detyruar bizneset ta shmangin importin nga këto dy vende dhe të gjejnë tregje të reja për furnizim në vendet e Bashkimit Evropian. Mallrat që më së shumti transportohen përmes transportit hekurudhor me tren janë xehet e nikelit, pastaj produktet e drurit, e të tjera, të cilat kryesisht vijnë nga Gjermania, Sllovenia dhe Kroacia, thotë për "Radion Evropa e Lirë", Behxhet Haziri, zëdhënës i kompanisë "Trainkos". Një ndër kompanitë që shfrytëzon linjën hekurudhore është kompania "Etika" nga Suhareka, që merret me shitjen e laminatit, dyerve dhe

dritareve. Pronari i kësaj kompanie, Adrian Hoxhaj, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" tregon se importon laminat nga shteti i Gjermanisë duke shfrytëzuar infrastrukturën hekurudhore për shkak se, siç thotë ai, ka kosto më të ulët financiare. "Kompania jonë transporton me tren, për arsye se është më lirë dhe bartim sasi më të madhe, sasi kjo që nuk mund të transportohet me kamionë. Transporti realizohet nga shteti i Gjermanisë, pasi atje e kemi gjetur tregun më të përshtatshëm", ka thënë Hoxhaj. Përfaqësues të komunitetit të biznesit, ndërkaq theksojnë se arsyeja e rritjes së sasisë së produkteve të importuara përmes transportit hekurudhor ndërlidhet edhe me taksën 100 përqind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare për Biznes, në një prononcim për "Radio Evropa e Lirë" thotë se pas vendosjes së taksës, çmimi i transportit të mallrave nga Serbia dhe Bosnja është rritur, kështu që bizneset si alternativë më të favorshme përdorin shfrytëzimin e transportit përmes linjave hekurudhore për importin e mallrave nga vendet e tjera evropiane. "Pikërisht kjo është arsyeja sepse shumë produkte që janë bartur nga Serbia janë zëvendësuar me prodhimet nga vendet e Bashkimit Evropian dhe se ato janë duke u bartur



përmes transportit hekurudhor. Kostoja financiare e transportit hekurudhor është më e lirë, pavarësisht se relacionet janë më të gjata dhe vonesat janë më të mëdha", ka thënë Shahini. Infrastruktura hekurudhore në Kosovë aktualisht vazhdon të përballet me një gjendje jo të mirë. Binarët, ndërtesat e stacioneve, stabilimentet sinjalizuese, pastaj operimet hekurudhore, lokomotivat, vagonët e udhëtarëve janë të vjetruara. Shpejtësia e trenave, për shkak të kushteve teknike në linjat aktuale, mund të zhvillohet në 50 kilometra në orë, kurse me renovimin e hekurudhave trenat do të qarkullojnë deri në 150

kilometra në orë. Modernizimi i infrastrukturës hekurudhore do ta rriste edhe më shumë transportin e mallrave, thotë Agim Shahini, sipas të cilit, me gjithë rritjen qarkullimit të mallrave me tren, kjo alternativë shfrytëzohet në mënyrë minimale për shkak të infrastrukturës së dobët. Por, bizneset këtë dobësi e kanë për shkak se aktualisht hekurudhat e Kosovës nuk kanë mundur të ofrojnë shërbime të ndryshme për operatorë të ndryshëm ekonomikë dhe kjo ka bërë që bizneset të orientohen ose në porte të ndryshme, si atë të Durrësit, Selanikut apo Tivarit dhe nga atje t'i bartin mallrat me

maune të ndryshme. Kurse në të kaluarën, hekurudhat kanë zënë vend të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë së vendit, transportit dhe rritjes së forcës konkurruese të shumë operatorëve ekonomikë, që kanë përdorur hekurudhat si mundësi më e lirë për transport. Në fillim të këtij viti ka nisur rehabilitimi i segmentit të parë hekurudhor në relacionin Prishtinë - Hani i Elezit në kufi me Maqedoninë, që pritet të përfundojë në vitin 2021. Ndërkohë, është paralajmëruar që së shpejti të fillojë edhe linja e dytë, që përfshin rrjetin hekurudhor Prishtinë - Leshak në kufirin me Serbinë.

SBASHK-u me veprime konkrete kundër mbylljes së shkollave në Kamenicë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 GUSHT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës së Kosovës (SBASHK) ka dalë kundër mbylljes së shkollave në Kamenicë. Sipas SBASHK-ut, ky vendim i kryetarit të Kamenicës, Qëndron Kastrati, është i ngutshëm dhe i paanalizuar fare dhe se do të sillte komplikime dhe përplasje. "Kuvendi i Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kamenicës mbajti mbledhje të jashtëzakonshme duke marrë qëndrim unanimit për hapa konkretë në kundërshtim të mbylljes së shkollave në këtë komunë", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, bashkë me udhëheqës të tjerë të nivelit qendror, të cilët kanë përsëritur kundërshtimin ndaj idesë për

mbylljen e shkollave në këtë komunë, duke konsideruar se ky veprim është i ngutshëm, i paanalizuar mirë dhe se do të sillte komplikime dhe përplasje. Në takimin e jashtëzakonshëm Kuvendi i Sindikatave të Arsimit Fillor e të Mesëm të Kamenicës, në mbështetje të SBASHK-ut në nivel vendi, mori vendim të hapur konkret të reagimit kundër mbylljes së shkollave në këtë komunë. SBASHK-u ka ftuar mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit që ta kundërshtojnë mbylljen e shkollave dhe që në ditën e parë të mesimit, më 2 shtator, të jenë secili në shkollën e tij për ta nisur vitin shkollor. "Nëse kryetari Kastrati vazhdon angazhimet për ta realizuar idenë e mbylljes së shkollave, atëherë në ditën e dytë të mesimit, më 3 shtator, i tërë sistemi arsimor në Kamenicë do të shkojë në grevë dyorëshe. Në ditën e tretë mesimi do të vazhdojë në të gjitha shkollat e



Kamenicës dhe do të kërkohet nga kryetari Kastrati që brenda një jave të deklarohet se heq dorë nga ideja për mbyllje të shkollave. Nëse ai nuk e bën këtë veprim, atëherë të gjitha shkollat e Kamenicës do të shkojnë në grevë në kohë të

pacaktuar dhe me këtë veprim legjitim sindikal do të solidarizohen edhe punëtorët e arsimit nga e tërë Kosova me hapa konkretë sindikalë për të cilët do të vendosë Këshilli Drejtues i SBASHK-ut bashkë me kryetarët e niveleve komunale e të univer-

siteteve", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut. SBASHK-u i është drejtuar MASHT-it dhe institucioneve të tjera të Kosovës dhe asamblistëve të Kamenicës që të kërkojnë nga kryetari që të heqë dorë nga kjo ide e ngutshme.

Ministrja Ziviq dhe Elezaj bisedojnë për zhvillimet në sektorin e bujqësisë në Klinë

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Ministrja në detyrë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, me të cilin kanë biseduar lidhur me zhvillimet në sektorin e bujqësisë, përfshirë

këtu edhe ecurinë e implementimit të programeve mbështetëse të ministrisë për këtë vit.

Ministrja Ziviq ka rikonfirmuar gatishmërinë e saj për ta thelluar bashkëpunimin me këtë komunë, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të

sektorit të bujqësisë në këtë rajon. Nga ana e tij, kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, e njoftoi ministren për zhvillimet në sektorin e bujqësisë në këtë komunë dhe me këtë rast shprehi përkushtimin e tij për të realizuar projekte zhvillimore në këtë sektor.



Pas 31 gushtit Telekomit nuk do të ofrojë më shërbime për 'Z-Mobile'

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Federata e Sindikatës së Pavarur (FSP) të Postë Telekomit të Kosovës (PTK) është duke e përcjellë nga afër procesin pas njoftimit zyrtar nga Telekomit i Kosovës për mosvazhdim të kontratës me "Z-Mobile", pas skadimit të saj më 30 korrik të këtij viti. Kështu është bërë me dije në njoftimin e FSP-së. "Për FSP-PTK është i papranueshëm deklarimi i menaxhmentit se periudha e tranzicionit do të zgjasë 30 deri 120 ditë. Vendimi i shkruar i menaxhmentit nuk u referohet as 30 ditëve e as 120 ditëve, por i referohet vetëm nenit 13 të kontratës, konkretisht periudhës së tranzicionit. Por, në nenin 13, konkretisht pika 13.1 dhe 13.2, u referohen tranzicionit vetëm në rastet e shkëputjes së parakohshme të kontratës, e jo tranzicionit pas skadimit të kontratës, siç është rasti ynë", është theksuar në njoftimin e FSP-PTK.

Më tej është theksuar se, pasi kontrata aktuale ka skaduar sipas afatit e nuk është ndërprerë parakohshëm, në këtë rast për FSP-PTK koha e tranzicionit të kontratës aktuale ka përfunduar më 30 korrik, pikërisht në datën e skadimit të kontratës. "Menaxhmenti i Telekomit të



Kosovës e ka njoftuar 'Z-Mobile' qysh më 24 qershor se kontrata aktuale nuk do të vazhdohet. Megjithatë, FSP-PTK e ka toleruar tranzicionin 30 ditë jo pse i takon Telekomit, por vetëm që t'u japin kohë ARKEP-it dhe Manaxhmentit të Telekomit që t'i kthehen numrat e marrë Telekomit. Por, duke u bazuar në përmendjen e 30 deri 120 ditëve tranzicion nga menaxhmenti i

Telekomit, si dhe duke u bazuar në paqartësinë e ARKEP për të marrë vendime lidhur me kthimin e numeracionit, u bëjmë me dije të gjitha institucioneve se pas datës 31 gusht nuk do të ofrohet më shërbime për 'Z-Mobile'", është thënë në këtë njoftim.

FSP-PTK ka kërkuar nga ARKEP-i që t'u përmbahet obligimeve të veta ligjore dhe konform edhe

kërkesës së fundit të Komisionit Hetimor Parlamentar t'ia kthejë numeracionin Telekomit të Kosovës. "Me këtë rast e falënderojmë Komisionin Hetimor Parlamentar për përgjegjësinë dhe punën e madhe në funksion të zbardhjes së gjendjes në Telekom, e posaçërisht për ndriçimin e fakteve rreth kontratës korruptive me 'Z-Mobile'. Prandaj, këtë paralajmërim me

kohë të FSP-PTK ta merrni seriozisht ashtu që periudhën e tranzicionit ta përfundoni brenda 30 ditëve. Përndryshe, të gjitha pasojat e mundshme pas datës 31 gusht do t'i bartin institucionet përgjegjëse, menaxhmenti i Telekomit të Kosovës si dhe ARKEP-i, përfundon deklarata e Këshillit Grevist të FSP-PTK-së", është thënë në njoftimin e FSP-PTK.

AKP-ja shpalli shitjen e re të aseteve përmes likuidimit nr. 50

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) zyrtarisht ka shpallur shitjen e aseteve përmes likuidimit nr. 50. Lista e tenderëve për privatizim me shitje të aseteve nr. 50 përbëjnë 133 asete, njësi atraktive të ndërmarrjeve shoqërore në Republikën e Kosovës, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vendin tonë. "Kjo valë e shitjeve me të gjitha asetet e tenderuara është aprovuar në Bordin e

Drejtorëve, kurse AKP i ka njoftuar paraprakisht të gjitha komunat përkatëse se këto asete të ndërmarrjeve shoqërore do të privatizohen dhe ka shpallur njoftimin për tender në faqen e saj të internetit dhe në mediat e shkruara dhe ato elektronike. Ju rikujtojmë se që nga muaji i kaluar Agjencia po i zbaton rregullat e reja të tenderit me çka janë thjeshtësuar më shumë procedurat e ofertimit, duke mundësuar lehtësime për procesin e ofertimit. Ato janë të publikuara edhe në ueb-

faqen e agjencisë", është thënë në njoftimin e AKP-së. Ofertat e mbyllura për njësitë, asetet që janë në shitje përmes shitjes së aseteve me likuidim nr. 50, duhet të dorëzohen në sallën e konferencave të "Grand Hotel"-it në Prishtinë më 23 shtator 2019, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, të shoqëruara edhe nga depozita e ofertës dhe tarifa për paraqitjen e ofertës, ashtu siç është parashikuar për secilin artikull. Kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë, duke filluar nga ora 12:30.



Kuvendi miraton marrëveshjen financiare IPA 2018

Marrëveshja IPA 2018, e nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Republikës së Kosovës i siguron rreth 90 milionë euro për projekte të ndryshme. Ministria në detyrë e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se kjo marrëveshje është tejet e rëndësishme për mbështetjen e vendit tonë gjatë procesit integruar në fusha qenësore si sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e ambientit

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 GUSHT - Në seancën e fundit plenare të legjislaturës së gjashtë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare IPA 2018 u miratua me shumicë të votave të deputetëve. "Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me Bashkimin Evropian (BE) kanë negociuar dhe nënshkruar Marrëveshjen Financiare IPA 2018 në vlerë prej 94.7 milion eurosh, ku 90.5 milionë euro financohen nga BE-ja dhe pjesa e mbetur bashkëfinancohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Nën koordinimin e MIE-së janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme rreth marrëveshjes financiare për IPA 2018", ka

thënë ministria në detyrë e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, duke theksuar rolin e kësaj marrëveshje. "Marrëveshja Financiare IPA 2018 është tejet e rëndësishme për mbështetjen e vendit tonë gjatë procesit integruar në fusha qenësore si sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e ambientit", ka thënë ministria Hoxha. Ajo ka falënderuar deputetët për trajtimin me prioritet të ratifikimit të kësaj marrëveshje duke i kontribuar në masë të madhe procesit reformues të Republikës së Kosovës.

Kjo marrëveshje pritet të hyjë në fuqi më së largu deri më 31 dhjetor 2019.

Marrëveshja u nënshkrua nga BE-ja në muajin shkurt, ndërkaq nga Kosova në muajin prill të vitit 2019. Kostoja totale e vlerësuar e programit IPA 2018 është 94,796,800 euro. Kontributi i BE-së është 90,500,000 euro, ndërsa



institucionet e Kosovës do të sigurojnë bashkëfinancim prej 4,926,800 eurosh. Kjo marrëveshje ka paraparë financimin e reformave për avancimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, mjedisit, energjisë, arsimit dhe punësimit. Në fushën e demokracisë dhe qeverisjes së mirë do të financohet bursa 'Skema e Profesionistëve të Rinj' apo Young Cell Scheme (YCS). Me anë të bursës, të rinjtë e Kosovës do të kenë mundësi t'i vijojnë studimet master në universitetet evropiane. Po ashtu, do të financohet mbështetja për ngritje të kapaciteteve të Kuvendit të Kosovës si dhe do të sigurohet pagesa për pjesëmarrjen e Kosovës në katër programet e BE-së.

Më tej theksohet se në fushën e

sundimit të ligjit do të mbështetet përafrimi i kornizës ligjore dhe institucionale me standarde të BE-së si dhe fuqizimi i pavarësisë, profesionalizmit, llogaridhënies dhe efijencës së sistemit të drejtësisë. Po ashtu, do të përkrahet lufta kundër korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Në fushën e të drejtave themelore do të përkrahet fuqizimi ekonomik i komuniteteve minoritare në Kosovë. Në fushën e mjedisit dhe energjisë do të ofrohen 40 milionë për adresimin e ndotjes së ajrit duke zëvendësuar elementet mjedisore të Kosovës B të cilat do ta sigurojnë zvogëlimin e emetimeve të pluhurit dhe NOx-it. Po ashtu, 4.9 milionë euro do të ofrohen për deponinë sanitare në Pejë si

dhe zhvillimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave në gjithë Kosovën. Ndërkaq në fushën e arsimit, 13 milionë euro do të ofrohen për përmirësimin e sistemit arsimor në Kosovë, me theks për avancimin e qasjes së grupeve të cenueshme në sistemin arsimor, përmirësimin e rangimit të Kosovës në PISA, si dhe ndërlidhjen e sistemit arsimor me tregun e punës.

Në fushën e punësimit, 3 milionë euro do të ofrohen për financimin e ngritjes së konkurrueshmërisë së Kosovës dhe mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Me 3.7 milionë euro do të financohet dizajni i sallës së koncerteve, do të përmirësohet qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike, si dhe do të avancohet komunikimi i asistencës së BE-së në Kosovë.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka përhëndetur vendimin e legjislaturës së gjashtë të Kuvendit të Kosovës për ratifikim të Marrëveshjes Financiare, IPA 2018 (Instrumenti i Paraanëtarësimit). Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", blloku evropian ka thënë se ky vendim "siguron mbështetjen e BE-së në reformat për qeverisje të mirë, sundim të ligjit, ambient, energji, edukim dhe punësim".



Komuna e Drenasit, apel qytetarëve: Të keni kujdes ndaj zjarrvënieve

DRENAS, 22 GUSHT (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka kërkuar nga të gjithë qytetarët të jenë aktivë në parandalimin e çfarëdo lloji të zjarreve dhe zjarrvënësve. "Stina në të cilën jemi po vazhdon të karakterizohet me temperatura të larta të ajrit, të cilat vazhdojnë të ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zgjerimin e vullshëm të zjarreve në sipërfaqe të hapura, malore dhe fushore. Me qëllim të evitimit të rrezikut nga zjarri, mbrojtjes së jetës së qytetarëve, të pronës, shtazëve dhe ambientit, apelojmë që të gjithë jemi të kujdesshëm dhe vigjilentë për shmangien e të gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit, vërejtjen dhe lajmërimin me kohë, si dhe të ndihmojmë në shuarjen e zjarreve. Për çfarëdo rasti luten qytetarët që të thërrasin në Qendrën Operative Emergjente, nëpërmjet numrit unik (integruar) emergjent - 112", është thënë në njoftimin e Komunes së Drenasit.



Vendosen edhe pesë njësi 'Te Pema', produkt vendor që pastron ajrin në qytet

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me ICK - Innovation Centre Kosovo, të enjten përuruar pesë njësi shtesë të këndeve "Te Pema" në Sheshin "Zahir Pajaziti". "Te

Pema" është pjesë e inkubatorit të Innovation Centre Kosova, i cili ka për qëllim vetëdijësimin dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. "Një bankë, kënd i tillë, kryen funksionin e 70 drunjve sa i

përket cilësisë së ajrit. Prodhim vendor, inovativ, efektiv dhe konkurrent. Kemi porositur njësi të tilla, përfshirë edhe versionin 'xl', që ka efektin e 150 drunjve", ka thënë kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.

Në Ferizaj diskutohet draftrregullorja e shërbimeve komunale

FERIZAJ, 22 GUSHT (ER) - Këtë të enjte është mbajtur diskutimi publik i draftrregullores për shërbimet komunale, e propozuar nga Inspektorati i Komunës së Ferizajt. Me këtë rast, kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyqi, ka thënë se kjo rregullore do të jetë në shërbim të qytetarëve dhe do t'i përmirësojë dukshëm edhe shërbimet e jetës së qytetarëve të Ferizajt. "Kjo draftrregullore është iniciuar nga Inspektorati, ka kaluar në Kuvendin e Komunës si draft, për t'u diskutuar pastaj me qytetarët, por edhe zyrtarët që merren me këtë proces dhe do të jetë një



dokument që do të na shërbejë shumë të gjithëve", ka thënë Gashi-Bytyqi.

Nga ana tjetër, koordinatori i

Inspektoratit të Komunës së Ferizajt, Ridvan Berisha, është shprehur se kjo rregullore është e një rëndësie shumë të madhe

sepse, sipas tij, deri më tani është punuar me një rregullore e cila ka qenë e vitit 2004 dhe ka qenë e zbatueshme pothuajse nga të gjitha institucionet. "Në koordinim me inspektorët e kemi parë të arsyeshme ta nisim një procedurë për ndërrimin e kësaj rregullore. Jemi munduar ta kalojmë si plotësim ndryshim, por duke pasur parasysh që kaloi mbi 30 për qind, e kemi ndryshuar në tërësi. Në këtë rregullore zbatuese kanë qenë shumë institucione, por tash janë vetëm inspektorët brenda inspektoratit të komunës. Me këtë rregullore gjohet që qenë të parapara me marka gjermane,

ka qenë e përealizueshme dhe procedurat e mëtutjeshme kanë mundur të iniciohen vetëm përmes gjykatës. Rregullorja e kaluar nuk ka pasur as gjoha administrative që ato të hyra që realizohen të hyjnë në buxhetin komunal, por kanë shkuar te Këshillin Gjyqësor ose në nivel qendror", ka thënë Berisha, përderisa ka përmendur edhe shumë ndryshime të tjera që janë bërë në këtë rregullore, bie fjala edhe tek Ligji i Ushqimit. Po ashtu, është bërë me dije se kjo draftrregullore dritën jeshile për zbatim do ta marrë në njërin nga mbledhjet e radhës të Kuvendit të komunës.

DKRS-ja në Mitrovicë dhuron pajisje sportive për parkun 'Tjegullorja'

MITROVICË, 22 GUSHT (ER) - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sportit (DKRS) në Komunën e Mitrovicës ka ndarë disa pajisje sportive për parkun "Tjegullorja" në lagjen Bair, i cili po frekuentohet në masë të madhe nga fëmijë të moshave të ndryshme. Me këtë rast, Tafil Peci, drejtor i DKRS-së, ka bërë

me dije se duke pasur parasysh se ky park po ofron hapësira rekreative për të rinjtë tanë, ne si drejtori kemi vendosur ta ndihmojmë me pajisje sportive. "Parku Tjegullorja është një park shumë i bukur i cili shfrytëzohet nga fëmijët e asaj ane si dhe mirëmbahet me kujdes të shtuar nga personat përgjegjës,

prandaj drejtoria jonë ka vendosur t'i dhurojë disa pajisje sportive, që fëmijët tanë të kenë mundësi më të mëdha për aktivitete dhe rekreacione sportive", ka thënë Peci. Pajisjet e dhuruara kryesisht ishin topa futbollit, basketbolli, reketa tenisi, topa tenisi si dhe bateria.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (24)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin
NOVOSELLA**

Baca Adem Demaçi, ishte patriot, njeri shumë i drejtë dhe real si askush tjetër në këtë botë. Mbetet Lider i përjetshëm i kombit shqiptar!

31 korrik 2018,
Hajrullah Hasani

Ngushëllime familjes së nderuar Demaçi, ngushëllime gjithë atdhetarëve shqiptar! Baca ishte njeri i madh, që nuk përsëritet!

31 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Simbol i qëndrueshmërisë për një shekull! Ky ishte Baca Adem, që nuk u thye kurrë!

31 korrik 2018,
Shpresa Gashi

I lehtë të qoftë dheu i Kosovës, për të cilën bëre aq shumë...! Do mbetesh frymëzim i imi për tanë jetën...! Prehu në paqe, Bacë!...

31 korrik 2018,
Mustafë Zenunaj, Klinë

U realizoftë porosia dhe u shpërbleftë sakrificat e Bacës Adem! Baca, mbetet simbol qëndrese, fanar drite që nuk shuhet kurrë!

31 korrik 2018,
Besa Luzha

Ti je Promethe i Antikës, Skënderbe i Mesjetës, Mendela i Evropës! Epiteti i tij është i veçantë! Adem Demaçi ishte luftëtar për të drejtat e çdo njeriu, pa dallim feje a kombësie!

31 korrik 2018,
Nuhi (mbiemri i palexueshëm)

Qoftë i përjetshëm kujtimi për ty, simboli i qëndresës sonë! U rritem duke marrë mësim nga qëndresa Juaj, edhe pse ishe në burg aq gjatë, ndikimi i veprës dhe idealit tuaj ishte i madh dhe me vlerë, për gjithë kombin shqiptar! Lavdi të qoftë për jetë e mot!

31 korrik 2018,
Sinan Kryeziu, Therandë

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, i kësaj toke shqiptare, për të cilën bëre aq shumë. Do të mbetesh gjithmonë frymëzim i tërë popullit shqiptar!

31 korrik 2018,
Jusuf Jusufi, Preshevë

Ngushëllimet më të sinqerta për Mareshalin e çështjes shqiptare!

31 korrik 2018,
Hilmi Dauti, Prishtinë

Krenaria e kombit, simbol i qëndresës shqiptare! Jemi krenar që të patëm dhe u rritem, të frymëzuar nga Ju, legjenda e shqiptarisë!

31 korrik 2018,
Xhevat Haliti

Ngushëllime familjes Demaçi dhe gjithë Kosovës për Bacën Adem, pishtarin e lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës!

31 korrik 2018,
Destan Gashi, Balincë,
Malishevë

Nderime kolosit të atdheut, bacës Adem Demaçi, i cili gjatë gjithë jetës mbeti pishtar i luftës për liri të popullit të vet!

31 korrik 2018,
Fatmir Thaçi, Mירushë

Erdhe në këtë botë për ta ndryshuar, dhe u bërë pashlyeshëm njeri që ua ndryshoi mendësinë shqiptarëve!

31 korrik 2018,
Besim Hasani, president i
Komitetit Olimpik të Kosovës

Jemi krenar që ti i takove popullit ashtu siç ishe ti. Të kam xhelozuar me tërë qenien që nuk isha si Ju! Lavdi të qoftë për jetë e mot, Bacë Adem!

31 korrik 2018,
Avdi Gjata

E nderuam emrin e Bacës që kur kemi dëgjuar për synimin e tij, për idealin e tij! U rritem dhe vazhduam, betejat të frymëzuar nga qëndresa e Bacës Adem. Ai na dha forcë për qëndresë, duke u bërë vet shembull për do atdhetar! Atdheu do të ia ruaj lavdinë përherë!

31 korrik 2018,
pasojnë disa nënshkrime:
Idriz Lahu, Musa Leku, Bastrije Lahu,
Shefqet, Barat Sylejmani, Isuf Lahu...

Njeri që gjithmonë ka qenë dhe mbeti i pathyeshëm dhe i pamposhtur! Mbetet shembull edhe për të ardhmen e këtij populli me qëndresën e tij!

31 korrik 2018,
Ismet Maloku

Baca Adem ishte frymëzim për të gjithë shqiptarët! Në emër të AAK-së degët në Zvicër dhe në Francë, iu shprehim ngushëllimet familjes së Bacës Adem! Lavdi e përjetshme!

31 korrik 2018,
Mustafë Alimusaj

Baca Adem, prehu në paqe të cilën e fitove si askush tjetër. Ne nuk ditëm ta çmojmë thesarin e çmueshëm kombëtar, Adem Demaçin, që na e fali Perëndia! Ne u koritem me ty! Ti nuk u korite kurrë! Të lumtë Bacë, nuk di tjetër çfarë të them!

31 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi jetës dhe veprës viganit, njeriut madhështor, marathonomakut të pandalshëm të luftës për liri, Bacës Adem Demaçi!

31 korrik 2018,
Familja Salihu dhe Resmija

Njeriu që e meritoi respektin e veçantë, Ky është Adem Demaçi, i cili tërë jetën ia kushtoi lirisë së popullit tonë dhe gjithë Kosovës! Përulemi para veprës së paarrishme të Bacës Adem!

31 korrik 2018,
Haki Berisha

Lavdi të pavdekshmit dhe të përjetshmit tonë, Bacës Adem! Ti i dhe çdo gjë e nuk i more asgjë Kosovës. Ti iu dhe të gjithëve nga vetja, për të mbetur i pavdekshëm përherë!

31 korrik 2018,
Hysen Lumi, Bllacë

Kam pasur privilegj të jetoj në Epokën tënde, të cilës i ke lënë vullë, që nuk shlyhet kurrë! Pata rastin ta njoh në Partinë Parlamentare të Kosovës gjatë viteve 1996-1998! Lavdi të qoftë përherë!

31 korrik 2018,
Ismet Salihu

Sjellim nderimet më të larta dhe më të sinqerta për bacën Adem Demaçi, nga Kosova Lindore!



Zoti e pastë mëshiruar me xhenet njeriun që ia fali gjithë jetën luftës për liri, jo vetëm të popullit të vet!

31 korrik 2018,
Prof. Vesel L. Muhoc

Nderime njeriut, të cilit dikur kishim frikë t'ia përmendim emrin, nderime njeriut që sot i themi Lavdi për krejt çka bëri për Kosovën dhe popullin shqiptar!

31 korrik 2018,
Agim Thaçi

Nga Karaçeva e brezit kufitar, kemi ardhur për ngushëllime por edhe për të nderuar familjen emblemë, të Bacës Adem Demaçi! U ndave nga jeta por mbetsh frymëzim për ne! Lavdi për jetë e mot, Bacë!

31 korrik 2018,
Selver (mbiemri i palexueshëm)

Ngushëllime gjithë popullit shqiptar për të pavdekshmin, Bacën Adem Demaçi! Vepra e Adem Demaçit do jetoj gjatë! Ai mbetet shembull se si duhet luftuar për lirinë e popullit dhe të atdheut!

31 korrik 2018,
Veli Kajtazi

Zëri i bacë nuk ka la shteg për tërheqje në luftën për liri barazi! Ky njeri kaloi kufijtë e kohës me veprën e tij! Do jetojë përjetë kujtimi për Bacën!

31 korrik 2018,
Besim (mbiemri i palexueshëm)

Prehu në paqe, njeriu ynë, simbol i sakrificës sublime!

31 korrik 2018,
N. Ajeti

Ai lindi për të mos vdekur kurrë! Mbetet rast unik në histori, jo vetëm të popullit tonë, por edhe më gjerë!

31 korrik 2018,
Doruntina (mbiemri mungon)

Veprat tuaja do të kuptohen më vonë! Të qoftë lavdi Bacë!

31 korrik 2018,
Bujar Ahmeti

Kolosët si baca Adem, lindin një herë në shekull! Kishim fatin që jetuam në Epokën e Bacës së madh!

31 korrik 2018,
Heset Loku

(Vazhdon në numrin e
ardhshëm)

BE-ja kundër Trumpit, refuzon kthimin e Ruisë në G7

BRUKSEL, 22 GUSHT - Bashkimi Evropian kundërshton një ftesë të pakushtëzuar për Ruisë, që do të mundësonte ribashkimin e saj në bisedimet mes liderëve botërorë të G7-ës, tha për Reuters një zyrtar i lartë evropian.

Shtatë udhëheqës të vendeve më të zhvilluara dhe industrializuara të globit do të takohen këtë fundjavë në resortin francez Biarritz. Format, i njohur dikur si G8 e përfshinte edhe Ruisë, por ajo u

përfshijta prej radhëve të tij në 2014-ën, pas aneksimit të Krimesë dhe mbështetjes që Moskë dhe rebelëve në lindje të vendit.

Duke folur në kushte anonimiteti, zyrtari u shpreh se arsytet e përjashtimit të Ruisë "mbeten të vlefshme" dhe se çdo ofertë kthimi do të ishte në fakt "një shenjë dobësie". Presidenti amerikan, Donald Trump është shprehur se mbështet kthimin e Moskës në

grupin e G7-ës, takimin e të cilit, Shtetet e Bashkuara do ta organizojnë vitin që vjen.

Deklarata e tij erdhi disa ditë para se të mbërrijë në jug të Francës për të marrë pjesë në samitin e sivjetshëm të grupit. "Është shumë më e përshtatshme të kemi Ruisë aty. Duhet të kthehet në G8, sepse shumë gjëra për të cilat ne flasim kanë të bëjnë pikërisht me të", ka qenë komenti i presidentit amerikan.



Franca kundër rihapjes së bisedimeve për Brexit-in

Presidenti francez Emmanuel Macron tha se një Brexit pa marrëveshje nuk është zgjidhja jonë, por është detyra jonë të jemi të përgatitur edhe për atë opsion dhe është shumë e rëndësishme që BE-ja të mbajë marrëdhënie të privileguara me Britaninë

PARIS, 22 GUSHT - Kryeministri britanik Boris Johnson po qëndron në Paris për diskutime me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, lidhur me Brexitin dhe mundësinë e rihapjes së marrëveshjes të cilën Londra e ka arritur me Bashkimin Evropian. Johnson, në një konferencë për media së bashku me presidentin Macron, tha se vota e britanikëve për të lënë BE-në duhet të respektohet. Në anën tjetër, presidenti Macron tha se "ne e respektojmë" vendimin e Britanisë për t'u

larguar nga BE-ja. "Një Brexit pa marrëveshje nuk është zgjidhja jonë, por është detyra jonë të jemi të përgatitur edhe për atë opsion", tha Macroni. Ai theksoi se është shumë e rëndësishme që BE-ja të mbajë marrëdhënie të privileguara me Britaninë. Sipas tij, muaji i ardhshëm mund të jetë i dobishëm, por nuk mund të ndryshojë asgjë në marrëveshjen e tërheqjes.

Pavarësisht qëndrimit të palëkundur të presidentit Macron për të mos rihapur



bisedimet, kancelarja gjermane, Angela Merkel, ka treguar më shumë fleksibilitet në këtë drejtim.

Të mërkurën, ajo tha se çështja ishte në Britaninë e Madhe për të gjetur një plan të zbatueshëm. Kjo duket të jetë përpjekja e fundit e kryeministrit britanik për t'i bindur udhëheqësit evropianë që të ndryshohet marrëveshja e

Brexit-it.

Britania e Madhe duhet të dalë nga BE-ja më 31 tetor.

Gjatë një konference për media së bashku me kryeministrin Johnson, kancelarja Merkel tha se një zgjidhje mund të jetë e arritshme brenda 30 ditësh.

Duket se ajo që synon kancelarja Merkel janë bisedimet për një deklaratë politike, si një doku-

ment ligjërues jodetyrues për marrëdhëniet e ardhshme midis Britanisë së Madhe dhe BE-së, shkruan BBC.

Nga ana tjetër, kryeministri Johnson tha se një marrëveshje mund të arrihet me "durim të mjaftueshëm".

Çështja më e diskutueshme është ajo e kufirit irlandez.

Marrëveshja e negociuar nga BE-ja dhe ish-kryeministrja britanike, Theresa May është rrëzuar nga Parlamenti britanik tri herë radhazi.

Kryeministri Johnson ka këmbëngulur se Britania e Madhe dëshiron të largohet nga BE-ja me një marrëveshje të rinegociuar të tërheqjes, por që sipas tij, edhe nëse nuk do të ndodhë diçka e tillë, vendi do të dalë nga BE-ja më 31 tetor.

Pompeo shpreh mirënjohje për Danimarkën



WASHINGTON, 22 GUSHT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, shpreh mirënjohje për Danimarkën si aleatë të ShBA-së, pas anulimit të vizitës shtetërore që presidenti Donald Trump pritej të bënte atje në fillim të shtatorit. Departamenti i Shtetit tha se Pompeo foli me homologun e tij danez në telefon dhe diskutoi "mbi forcimin e bashkëpunimit në Arktik me Mbretërinë e

Danimarkës - duke përfshirë Grenlandën".

Në fillim të kësaj jave presidenti anuloi një vizitë në Danimarkë pas refuzimit të propozimit të tij që danezët t'i kërkojnë Grenlandës t'u shitet Shteteve të Bashkuara.

Kryeministrja daneze Mette Frederiksen tha të mërkurën se ndjeu keqardhje dhe u befusua që presidenti i ShBA-së Donald

Trump anuloi papritmas vizitën e tij të planifikuar në Danimarkë kur ajo kundërshtoi sugjerimin e tij për të blerë Grenlandën, territorin strategjik dhe të pasur me minerale, pjesë e Mbretërisë Daneze.

Më vonë, presidenti Trump pohoi se e anuloi vizitën pasi kryeministrja daneze bëri një koment "të pahijshëm" si reagim ndaj sugjerimit të tij.

Në Ankara mbahet samiti kushtuar Sirisë

ANKARA, 22 GUSHT - Presidenti rus, iranian dhe ai turk do të mbledhen në Ankara më 16 shtator për një samit kushtuar Sirisë, theksoi zëdhënësi i Presidencës turke. "Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan do të presë një samit trepalësh me Ruisë dhe Iranin në Ankara", deklaroi Ibrahim Kalin, në një konferencë me gazetarë. "Drejtuësit do të diskutojnë për marrëveshjen e arritur në vitin 2018 mes Moskës dhe

Ankarasë mbi Idlebin, bastioni i fundit i opozitës në Siri, ngritjen e një komisioni konstitucional dhe mënyrën për të vazhduar procesin politik", tha Kalin.

Njoftimi u bë në një kohë kur regjimi sirian, mbështetur nga Moskë dhe Teherani ka rimarrë qytetin strategjik të Khan Cheikhoun në jug të provincës së Idlebit.

Xhihadistët dhe rebelët, të mbështetur nga Ankaraja janë

tërhequr nga Khan Cheikhoun si dhe sektorët fqinj në veri të provincës së Hamas përballë avancimit të regjimit. "Rreth 900 civilë kanë humbur jetën nga bombardimet ajrore dhe artileria në Idleb zonat përreth në duart e xhihadistëve të Hayat Tahrir al-Cham dhe kryengritësve në provincat fqinje të Alepos, Hamas dhe Lataikes", sipas Observatorit sirian për të Drejtat e Njeriut.





Shpall konkurs për pranimin e fëmijëve të moshave të ndryshme (0,9 - 6 vjeç)

Aplikimi për regjistrim të fëmijëve fillon nga data:
10.08.2019 deri 30.08.2019

Për çdo informatë shtesë mund të drejtoheni përmes telefonit 045 714 713.



E jashtëzakonshme


Analiza e ADN-së shton misterin e liqenit plot me skelete

Shkencëtarët kishin menduar deri më sot se qindra skeletet e gjetura brenda liqenit Rupkund, në Himalajat indiane, kanë qenë të pelegrinëve që mund të kenë vdekur gjatë një stuhie rreth 1000 vjet më parë, por analizat më të fundit e hodhën poshtë këtë ide. Brenda liqenit janë jo pak, por 800 skelete njerëzish, ndaj kohët e fundit u krye një studim ADN-je



që shpresonte të hidhte pak dritë, por rezultatet vetëm sa e shtuan misterin.

FOTO E DITES



Një fermer mbledh arra gorgoni në Guangxi Zhuang, në Kinën jugore.

E rrallë

Supermarketet amerikane duken ndryshe në Kinë

Walmart është marka më e njohur e supermarketeve në ShBA. Jo një, por disa prej pronarëve të Walmart renditen mes 100 më të pasurve në botë. Kompania njihet për çmime më të lira në krahasim me markat e tjera, si dhe për numrin më të lartë të supermarketeve që kanë hapur. Ata janë zgjeruar në shumë vende por, megjithatë, në Kinë duken më ndryshe, pasi janë përshtatur me tregun vendës.



BARSOLETA E DITËS



- Bir, a po shkojmë në piknik?
- S'di bir, a është larg a?
- Qare nuk kam pa ta gjet një psikiatër të mirë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30
The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

“HOBBS & SHAW”

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30
ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Sot gjatë gjithë ditës do të mendoni vetëm për çështje punë dhe financiare. Duhet të mendoni edhe për çështjet e zemrës ndonjëherë.



DEMI

Keni rezultate të shkëlqyera në një projekt që vijnë si pasojë e bashkëpunimit shumë të mirë që keni me kolegët tuaj.



BINJAKËT

Kujtimet e ëmbla po ju lezetojnë ditën sot. Jeni të përkundur nga një ndjenjë kënaqësie që nuk e kuptoni nga vjen.



GAFORRJA

Sot dëshironi të qëndroni të qetë në ambientin tuaj që ju pëlqen aq shumë. Një ditë jo me ndonjë ngjarje të veçantë për t'u mbajtur mend.



LUANI

Duhet të mbani nën fre krenarinë tuaj dhe ambicien e tepruar sepse në të shkuarën keni bërë gabime që ju kanë kushtuar shtrenjtë.



VIRGJERESHA

I keni pasur çastet tuaja të lavdisë gjatë paradites së sotme dhe për këtë jeni shumë krenar. Mbrëmja paraqitet e qetë.



PESHORJA

Sot një ditë e mirë për takime pune ose konkurse shkolle. Fati është në anën tuaj dhe çdo gjë do të përfundojë në favorin tuaj.



AKREPI

Sot do të vendosni të kaloni një ditë me miqtë sepse ju duhet mendimi i tyre për një vendim të rëndësishëm që do të merrni.



SHIGJETARI

Jeni disi të pakënaqur me disa situatë që po ndodhin rreth jush. Do të kërkonit të gjeni fajtorin por nuk do të mundni dot.



BRICJAPI

Do t'ju vlerësojnë për aftësitë tuaja në punë sot dhe meritat do të jenë si morale ashtu edhe financiare.



UJORI

Sot çdo gjë që ju çon larg banales dhe vulgaritetit. Do të ndjeheni shumë të lirë.



PESHQIT

Po ju vijnë në mend momente që keni shumë dëshirë t'i riktheheni përsëri. Kujtime të bukura që thjesht po ju shoqërojnë gjatë ditës.

Diona ka një surprizë për fansat e saj



Diona Fona nuk e ka përmbyllur ende sezonin veror. Këngëtarja simpatike ka postuar në rrjetin social "Instagram" një video paralajmëruese të këngës së saj

të re për të cilën ka shkruar se do të publikohet së shpejti. "Kataleya" duket se do të quhet projekti muzikor në fjalë dhe ne mezi presim ta shohim dhe ta dëgjojmë.

Britney Spears mbështetet nga i dashuri në çaste të vështira



Këngëtarja e njohur britanike Britney Spears ka thënë se nuk di kujt t'i besojë më pasi, sipas saj, të jetosh në Los Angeles është mirë, por ndihesh keq me veten pasi aty ka shumë njerëz të këqij. "Më thyhet zemra kur shoh komente në postimet e mia në rrjete sociale, kështu unë kam vendosur

që më mos të shikoj, kam vendosur t'i lë anash ata që më urrejnë dhe le të bëjnë punën e tyre", ka shkruar Spears në rrjetin social në "Instagram". Pas këtij komenti këngëtarja u mbështet nga i dashuri i saj, Sam Asghari, i cili i shkroi asaj se ata e urrejnë pasi ata e kanë zemrën e mirë si ajo.



Gwen Stefani është frymëzim për Rita Orën

Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Prishtina, Rita Ora, ka thënë se për të është inspirim këngëtarja Gwen Stefani. Këtë e ka bërë me dije Rita Ora me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram".

Ora ka publikuar një video të këngëtares dhe të bendit No Doubt kur ata performonin para publikut para disa vjetëve. "Frymëzim përgjithmonë, Gwen Stefani, No Doubt", ka shkruar Rita Ora.

Demi Lovato i rikthehet filmit



Aktorja e njohur Demi Lovato është rikthyer sërish në fushën e aktrimit. Këtë e ka bërë me dije vetë Lovato me anë të një postimi në rrjetin social "Instagram". Në videon e publikuar nga Lovato është aktori dhe regjisor Will

Ferrel, i cili thotë se në filmin e tij të ri do të aktrojë edhe Demi Lovato. Në këtë video Ferrel i uron ditëlindjen Lovatos, duke i ofruar një tortë që t'u frynte qirinjve. Lovato do të aktrojë në komedinë e Will Ferrel "Eurovision".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Drenica dhe Llapi nuk mendojnë për humbje

Drenica dhe Llapi kanë paralajmëruar se humbja është e papranueshme nga përballja mes vete, e cila do të luhet sot (e premte) në kuadër të xhiros së dytë në IPKO Superligë. "Ne e dimë se ndaj Llapit nuk do të jetë aspak lehtë, sepse ka skuadër mjaft cilësore. Megjithatë, jemi përgatitur mirë që të paraqitemi sa më mirë dhe t'i shijojmë pikët e para në këtë edicion, po ashtu t'i kënaqim edhe shikuesit tanë", ka thënë Përparim Osmani, futbollist i KF Drenica



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 GUSHT - Llapi e fitoi ndeshjen e parë të këtij edicioni në Superligë ndaj Vushtrrisë me rezultat 4-1, kurse 4-1 është mposhtur Drenica nga Feronikeli. Kuqezinjtë e Skenderajt e presin sot (e premte) Llapin e Tahir Batatinës në ndeshjen e parë të xhiros së dytë në IPKO Superligë. Enis Zabergerja ka thënë se skuadra nga Podujeva, pavarësisht prej faktit se luan si mysafire, beson se do të marrë pikë. "E rëndësishme për skuadrën tonë është që edhe në këtë ndeshje të marrim pikë. Jemi përgatitur mirë dhe atmosfera në klub është e shkëlqyeshme", ka thënë Zabergerja.

Ndërsa klubi i Drenicës, pasi dështoi të marrë pikë ndaj rivalëve të Feronikelit, tash synon t'i marrë pikët e para në këtë edicion dhe në këtë mënyrë t'u rikthehet rezultatëve pozitive. Përparim Osmani i

Drenicës e ka vlerësuar lart skuadrën e Llapit, por beson se shikuesit e Drenicës do të ndahen të kënaqur pas ndeshjes. "Ne e dimë se ndaj Llapit nuk do të jetë aspak lehtë, sepse ka një skuadër mjaft cilësore. Megjithatë, jemi përgatitur mirë që të paraqitemi sa më mirë dhe t'i shijojmë pikët e para në këtë edicion, po ashtu t'i kënaqim edhe shikuesit tanë", ka thënë Osmani. Të shtunën zhvillohen dy ndeshjet e tjera ku Ferizaj kërkon edhe fitoren e dytë ndaj Gjilanit, derisa kjo e fundit kërkon këndellje pas humbjes nga Trepça '89. Ballkani i Ismet Munishit ka punë të vështirë ndaj kampionit aktual të elitës, Feronikelit. Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të dielën, kurse ndeshja në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit të Klinës është shtyrë për 25 shtator, pasi Federata e Futbollit e Kosovës ka vendosur të ruhet fusha për ndeshjen kualifikuese të Kosovës ndaj Çekisë.

IPKO SUPERLIGA

Të premten takohen:
17:00 Drenica - Llapi

Të shtunën takohen:
17:00 Ferizaj - Gjilani
17:00 Ballkani - Feronikeli

Të dielën takohen:
Drita - Flamurtari
Vushtrria - Trepça '89

LIGA E PARË

Të premten takohen:
17:00 Malisheva - KEK-u

Të shtunën takohen:
17:00 Ramiz Sadiku - Dardana

Të dielën takohen:
17:00 2 Korriku - Vitia
17:00 Onix - Vëllaznimi
17:00 Drenasi - Arbëria
17:00 Ulpiana - Istogu
17:00 Besa - Vllaznia
17:00 Trepça - Liria

SHKURT

Lëndohet edhe Shala

Pas mungesave të sigurta të Arbër Zenelit dhe Hekuran Kryeziut, ishte Milot Rashica që pësoi një lëndim. Tani në dyshim është edhe Herolind Shala për ndeshjet kualifikuese të muajit shtator, pasi ka pësuar një frakturë në dorën e djathtë. Ai pritet të futet në operim dhe do të mungojë disa javë. Numri i lëndimeve ka shkuar në katër, që për Bernard Challandesin janë shumë dhe do të ketë kokëdhimbje për ndeshjet ndaj Çekisë dhe Anglisë.

Vushtrria sot prezanton pesë transferime

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Vushtrria, ka bërë me dije se sot (e premte) do të bëjë prezantimin e pesë transferimeve të reja. "FC Vushtrria do ta bëjë të premtën prezantimin e përforcimeve të fundit. Katër lojtarë janë nga Brazili dhe një tjetër si lojtar i lirë. Prezantimi do të bëhet në orën 11:00 në stadiumin e klubit 'Ferki Aliu' në Vushtrri", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë. Kjo skuadër ndeshjen e parë e humbi nga Llapi 4-1, kurse në ndeshjen e dytë do të luajë ndaj Trepçës '89.

KOK-u nënshkruan kontratë me 'Physio Miracle'

Komiteti Olimpik i Kosovës ka ndëshkuar kontratë bashkëpunimi me kompaninë "Physio Miracle", e cila ofron shërbime fizioterapeutike dhe mjekësi sportive. Kontrata njëvjeçare u nënshkrua nga kryetari i KOK-ut, Besim Hasani dhe drejtori i "Physio Miracle", Bernard Tahirbegolli. "Është një lajm i mirë për KOK-un dhe sportistët e Kosovës, pasi në vazhdimësi e përpjekjeve tona për gjetjen e sponsorëve të rinj, që janë në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të KOK-ut, jemi takuar me kompaninë 'Physio Miracle', një kompani e re, por me ambicie shumë të mëdha dhe një organizatë e pajisur me mjete shumë të sofistikuara, që janë në funksion të përmirësimit të shëndetit të sportistëve. Kështu që, KOK-u ka vendosur të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi dhe ndihemi mirë që sot po e nënshkruajmë këtë kontratë", ka thënë Hasani.

Dukagjini tërhiqet nga garat, Prizreni në Superligë

KH Dukagjini është tërhequr nga garat e Superligës së hendbollit dhe Federata e Hendbollit të Kosovës ka vendosur që këtë vend ta mbulojë KH Prizreni, i cili është organizuar mjaft mirë kohët e fundit. "Bordi i FHK-së, në mbledhjen e mbajtur më datën 14. 08. 2019, pasi e mori shkresën e KH Dukagjini mbi tërheqjen nga garat e Superligës së meshkujve, unanimisht mori vendim që vendi i zbrazët në Superligë të plotësohet me KH Prizrenin, klub i cili për nga niveli organizativ, infrastrukturual dhe garantimit të pjesës financiare nga përgjegjësit komunalë, i plotëson të gjitha kriteret të jetë anëtar i Superligës së meshkujve", thuhet në njoftimin e Bordit të FHK-së.

Fury: Ruizin e rrah vetëm me një dorë

LONDER, 22 GUSHT - Tyson Fury e ka tallur Andy Ruiz Jr, duke pretenduar se do ta rrihte vetëm me një dorë kampionin botëror të peshave të rënda. Kampioni linear i peshave të rënda, Fury, do të rikthehet në veprim më 14 shtator, kur të

ndeshet me Otto Wallin përpara se të përballet me Deontay Wilder në një revansh vitin e ardhshëm. Dhe përpara se të ndeshet me suedezin e pamposhtur, ai ka për qëllim një ndeshje të madhe ndaj rivalit Ruiz Jr. I vetëmëruari

'Gypsy King' beson se mund ta mposhtë kampionin e unifikuar të peshave të rënda me lehtësi. Sipas tij, kjo fitore ndaj Ruiz Jr do të vinte vetëm me një dorë. "Dëgjo, ne kurrë nuk dimë se çfarë do të ndodhë në jetë dhe kurrë nuk

mund të them jo për asgjë", ka thënë fillimisht Fury. "Por një gjë që do të them është, unë do t'i lejoj fansat të vendosin, cilën dorë të vendos pas shpinës dhe ta rrah Ruizin me dorën tjetër - sepse më duhet vetëm një dorë për të", ka deklaruar Fury.



Kampioni i Gjermanisë në not do të garojë për Kosovën

PRISHTINË, 22 GUSHT - Notari me të ardhme të ndritur, Arti Krasniqi, tani e tutje do të garojë për Kosovën. 20-vjeçari, notar i ujërave të hapura, deri në vitin 2017 ka garuar për Gjermaninë, shtet ky me të cilin nuk i kanë munguar sukseset.

Federata e Notit e Kosovës ka marrë edhe zyrtarisht lejen nga Federata Gjermane e Notit për ta lejuar Artin të garojë për Kosovën. Krasniqi do të debutojë javën e ardhshme në Patra të Greqisë, ku prej 25-31 gusht 2019 do të mbahen Lojërat e Dyta Mesdhetare në Rërë Patra 2019, në të cilat Komiteti Olimpik i Kosovës do të marrë pjesë për herë të parë.

Arti në fund të muajit qershor u bë kampion i Gjermanisë në 10 kilometra, kurse për disa vjet është bërë kampion në Maratonën Ndërkombëtare Kosova 2019, në distancë 4.2 kilometra. Në Gjermani, ai është vlerësuar një prej notarëve më të mirë në distanca të gjata. Në Patra 2019 do të garojë në distancë 5 km. Krahas Artit, Kosovën në Patra 2019 do



ta përfaqësojnë edhe ekipet e beach volleyt në të dyja konkurrencat, Dhuratë Ismajli, Valmire Ramadani dhe Faton Mustafa e Armend Berisha. Në

Lojërat Mesdhetare në Rërë Patra 2019 marrin pjesë 26 shtete, anëtare të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare.

Ronaldo: Messi më bëri futbollist më të mirë

TORINO, 22 GUSHT - Cristiano Ronaldo ka pranuar se të dy, ai dhe Lionel Messi, kanë përtuar nga rivaliteti i tyre i gjatë. Portugezi dhe argjentinasin kanë dominuar totalisht në futbollin botëror në dekadën e fundit, duke fituar nga pesë "Topa të artë" secili. Dyshja, gjithashtu, prodhoi rivalitet maksimal në La Liga për gati dhjetë vjet, me Ronaldon që luajti për Real Madridin midis viteve 2009 dhe 2018, para se të transferohej te Juventus. Kjo periudhë kohore pa Barcelonën të fitonte gjashtë tituj kampioni në Spanjë, ndaj dy titujve të Real Madridit. Ronaldo dhe të bardhët ruajtën dominimin në Evropë, me katër kurora të Ligës së Kampionëve ndaj dy të tuara nga skuadra e Messit. E gjitha kjo u shoqërua me një rivalitet të ethshëm, por Ronaldo thotë se ka shumë admirim mes të dyve. Ai beson se të dy lojtarët e kuptojnë që e kanë ndihmuar njëri-tjetrin t'i



arrijnë lartësitë rekorde. "Unë me të vërtetë e admiroj karrierën që ai ka pasur deri më tani.

Nga ana e tij, Messi ka thënë tashmë se kishte problem, kur u largova nga kampionati spanjoll, sepse është një rivalitet që ai e vlerëson", ka deklaruar sulmuesi i Juventusit, Cristiano Ronaldo. "Ishte një rivalitet i mirë, që ekziston në futboll, por ky nuk bën përfundim. Michael Jordan kishte rivalë në basketboll, Ayrton Senna dhe Alain Prost ishin rivalë të shkëlqyeshëm në Formula 1, e vetmja pikë e përbashkët midis të gjitha rivalitetëve të mëdha në sport është se ato janë të shëndetshme. Messi më bën një lojtar më të mirë dhe anasjelltas. Unë kam një marrëdhënie të shkëlqyeshme profesionale me Messin, sepse kemi ndarë të njëjtat momente për 15 vjet. Kurrë nuk kam qenë duke darkuar me të, por pse jo në të ardhmen? Unë nuk do të kisha problem ta bëja këtë", ka deklaruar Ronaldo.

SHKURT

Realit, 100 milionë dhe tre lojtarë për Neymarin

Pas ofertës së Barcelonës për Neymarin, e cila u refuzua nga klubi i PSG-së, ishte radha e Realit të Madridit për ta paraqitur ofertën e saj për brazilianin. Siç raportoi "L'Equipe" në Francë, madrilenët kishin përgatitur një mega-ofertë për Neymarin. 100 milionë euro dhe plot tre yje si Bale, James dhe Navas, në këmbim të yllit brazilian. Të tre këta lojtarë po kalojnë kohë të vështira në Madrid dhe formacioni duket shumë larg me Zidanin në stol dhe kështu largimi do të ishte një opsion më i mirë. Por, është PSG-ja që edhe këtë ofertë të majtë e ka refuzuar, duke tentuar ta mbajë sërish në ekip Neymarin.

Lukaku: Fajtorë ishim unë, Pogba dhe Sanchez

Romelu Lukaku ka goditur Manchester Unitedin për mosbërjen e mjaftueshme për ta mbrojtur atë në media dhe pretendon se ai, Paul Pogba dhe Alexis Sanchez, vazhdimisht u bënë pre e sulmeve. Repreruesi belg iu bashkua Interit para mbylljes së afatit kalimtar të Ligës Premierë për një shifër prej 74 milionë eurosh, vetëm dy vjet nga transferimi i tij në "Old Trafford" nga Evertoni. "Ata duhet të gjejnë dikë. Është Pogba, jam unë ose është Alexis. Të tre ishim të fajësuar gjatë gjithë kohës. Ata duhet të gjejnë dikë për të fajësuar. Unë e ngreha dorën time, pasi këtë vit nuk mendoj se isha i vetmi që luajti keq. Shumë njerëz po luanin keq, por ata duhej ta gjenin fajtorin. Nëse ata duan të ma lënë fajin, ju e dini se çfarë, bëni atë, bëni atë që duhet të bëni", ka thënë Lukaku. "Mendoj se ekipi ka aq shumë potencial për të bërë gjëra të shkëlqyera. Ka shumë talent, por nuk është vetëm talent; ju me të vërtetë duhet të ndërtoni një ekip", ka shtuar Lukaku.

Plot oferta për Havertzin

Me paraqitjet e tij të jashtëzakonshme në sezonin e kaluar 20-vjeçari Kai Havertz ka zgjuar vëmendjen e top klubeve evropiane. "Sport 1" raportoi se për shërbimet e talentit të Leverkusenit kanë shprehur interesim Liverpooli, Manchester City, Manchester Unitedi, Barcelona e Real Madridi. Havertz kishte shënuar në sezonin e kaluar 20 gola në 42 paraqitje, derisa vlerësohet me 99.5 milionë euro.

Mourinho: Vetëm hajdutet ankohen nga kamerat e sigurisë

VAR-i ka filluar së aplikuari si teknologji tash e dy vjet, ku në disa gara e kampionate më herët e disa më vonë. Megjithatë, kjo teknologji ka minimizuar gabimet e gjyqtarëve në një ndeshje dhe po shihet si diçka pozitive për futbollin. Por, ka edhe disa nga ata që janë kundër VAR-it dhe e kanë shprehur disa herë këtë duke justifikuar vonesat e ndeshjet e gjëra të ndryshme. Trajneri i njohur portugez Jose Mourinho është bërë i fundit nga bota e futbollit që ka folur për VAR-in, duke thënë se vetëm hajdutët mund të ankohen për të. "Vetëm hajdutët mund të ankohen në lidhje me futjen e kamerave të sigurisë", ka thënë Mourinho.

Mitroglou huazohet te PSV-ja

PSV Eindhoveni përforcon sulmin me Costas Mitroglou. "Bomberi" grek do të tentojë të rikthehet në formën më të mirë në kampionatin holandez pas aventurave me shumë epike si Fulham, Olympiacos, Benfica e Marseille. Së fundmi 31-vjeçari luajti me Galatasarayn, por pas 6 muajsh drejtuesit nuk ishin të kënaqur me paraqitjet e tij, ndaj vendosën ta huazonin për një sezon te PSV-ja, me klubin holandez që ka pranuar të paguajë 1.2 milion euro për këtë operacion. Në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar me gjigantët turq, Mitroglou u aktivizua në vetëm 7 ndeshje të kampionatit, duke shënuar vetëm 1 gol, statistika këto aspak të mira për një sulmues të këtij niveli.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja /Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
 Departament za Financije i Opšte Sluzbe
 Department of Finances and General Services

Bënë
SHPALLJEN E KONKURSIT

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Integrim Evropian 2 (1 pozitë)
Ref: DIEKP-Ref 10/2019
Njësia Organizative: Departamenti Integritimit Evropian dhe Koordinim të Politikave
Vend i punës: Prishtinë
Kategoria funksionale: Niveli Profesional
Koeficienti/ grada: 7
Lloji i pozitës: E karrierës

Qëllimi i vendit të punës:

Siguron zbatimin e politikave në përputhje me normat evropiane dhe koordinon procesin e integritimit evropian brenda institucionit duke siguruar përputhshmërinë e politikave, planeve dhe strategjive me prioritetet e BE-së për Kosovën dhe standardet e BE-së.

Detyrat kryesore:

- Merr pjesë në hartimin dhe miratimin e planit të punës dhe afatet kohore me drejtuesin dhe stafin profesional të nivelit më të lartë për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve përkatëse në fushën e integritimit evropian;
- Bën hulumtime dhe analiza të politikave dhe procedurave të integritimit në BE në fushat përkatëse dhe kontribuon në ofrimin e këshillave për drejtuesit e lartë rreth integritimit evropian, sipas udhëzimeve të stafit më të lartë/me më shumë përvojë;
- Ndërlidhet me zyrtarë të lartë në përgatitjen e raporteve dhe rekomandimeve rreth zhvillimit dhe avancimit të kornizave të politikave dhe asaj rregullative në përputhje me normat e BE-së;
